



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 637/prot.  
4

Tiranë, më 11.02.2020

VENDIM

Nr. 8, datë 11.02.2020

***“Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë të studimeve “Master Profesional” në “Mësuesi në Arsimin Fillor”, në Departamentin e Psikologji-Pedagogjisë, Fakulteti Shkencave Sociale”***

Bazuar në nenin 3, pika 2, gërma *b*; nenin 38, pika 1, gërma *dh*; nenin 75 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Kreun IV/A, pika 3, gërma *b*, të Udhëzimit të MASR-së nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, nenin 31, gërmat *f* dhe *j* dhe nenin 105 të Statutit të Universitetit të Tiranës, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 11.02.2020;

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë të studimeve “Master Profesional” në “Mësuesi në Arsimin Fillor”, në Departamentin e Psikologji-Pedagogjisë, Fakulteti Shkencave Sociale, sipas dokumentacionit bashkëngjitur.
2. Ky vendim i përcillet në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për procedurat e mëtejshme të miratimit.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
PROF. DR. M. MYR KONI

